



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 17 paragrafi 1 pika f) dhe p) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RK-së”, nr.28/2008), nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr.04/L-111 dhe nr.05/L-009, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e pestë të rregullt, e mbajtur më datën 05.08.2020, merr këtë:

V E N D I M Nr.38/2020/KG

për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes publike-komunale
“Ekologjia” Sh.A. Graçanica

Neni 1

Emërohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen publike-komunale
“Ekologjia” Sh.A. Graçanica

Neni 2

Për anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve emërohen:

1. Nebojša Maksimović, jurist i diplomuar
2. Jelena Božić, juriste e diplomuar
3. Srđan Petković, ekonomist i diplomuar

Neni 3

Komisioni Komunal i Aksionarëve është i detyruar që, në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për shoqëritë tregtare dhe ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, të ushtrojë të drejtat dhe të ndërmarrë veprime në emër të Komunës së Graçanicës, si themeluese e Ndërmarrjes publike-komunale.

Neni 4

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi pushon të jetë i vlefshëm Vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes publike-komunale (nr.8509/16 nga 22.12.2016) dhe Vendimi nr.04/2018/KG për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes publike-komunale (numri arkivor 726/18 nga 31.01.2018).

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

